



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.1084/2017

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hasan Shala kryesues, Fejzullah Rexhepi dhe Adnan Konushevci anëtar, si dhe me pjesmarrjen e Zyrtarit Ligjorë Ardian Maxhuni, duke vendosur përkitazi me ankesën e Rrjetit Ballkanik për Gazetari Hulumtuese BIRN dhe Internews Kosova (IKS), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, dega në Gjilan, për shkak të Thyerjes së Heshtjes Zgjedhore, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me 21.11.2017, mori këtë:

## V E N D I M

**REFUZOHET** si e pabazuar ankesa e Rrjetit Ballkanik për Gazetari Hulumtuese BIRN dhe Internews Kosova (IKS), me seli në Prishtinë, me shenjen ZL.Anr.1084/2017 e datës 19.11.2017, e parashtruar kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, dega në Gjilan, me të cilën ka kërkuar që t'ju shqiptohet dënimi me gjobë, për shkak të Thyerjes së Heshtjes Zgjedhore, në raundin e dytë të Zgjedhjeve Lokale të mbajtura më 19.11.2017.

## A r s y e t i m

PZAP-i më datë 19.11.2017, ka pranuar ankesë nga Rrjeti Ballkanik për Gazetari Hulumtuese BIRN dhe Internews Kosova (IKS) në të cilën ka theksur se me datë 19.11.2017 në ora 10:40, militantët nga radhët e subjektit politik LDK kanë shpërndarë një komunikat për media, përmes së cilës bëhet thirrje që të rikonfirmohet rezultati i Zgjedhjeve Lokale të datës 22.10.2017. Më tutje theksohet se në përmbajtjen e komunikatës shprehet mesazhi i kandidatit nga radhët e subjektit politik LDK, për kryetar të komunës së Gjilanit.

Më tej ka theksuar se ky veprim është në kundërshtim me nenin 36 paragrafi 1 pika b) e Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme.

Në mbështetje të pretendimeve ka bashkangjitur një fotografi lidhur me rastin në fjalë.

Subjekti politik LDK në përgjigjen në ankesë të datës 20.11.2017, ka theksuar se bëhet fjalë lidhur me një deklaratë të zakonshme të kandidatit nga radhët e subjektit politik LDK për komunën e Gjilanit, duke shtuar se nga përmbajtja e deklaratës mund të vërehet qartë se ka thirrje të zakonshme për dalje në zgjedhje duke mos përmendur në asnjë rast emërin e kandidatit, subjektit, prandaj nga të cekurat PZAP-it i ka kërkuar që ankesën e ankuesit ta refuzoj si të pa bazuar.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 2 të LZP-së, gjeti se:

### **Ankesa është e pabazuar**

Pretendimet ankimore të parashtruesit të ankesës BIRN dhe Internews Kosova (IKS), me seli në Prishtinë lidhur me shkeljen e pretenduar të thyerjes së heshtjes zgjedhore, përmes shpërndarjes së një komunikate në email nga ana e subjektit politik LDK në komunën e Gjilanit, Paneli i vlerësoj se janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj si të pa bazuara, në munges të provave bindëse për faktin se nga fotografia e ofruar si provë, që gjendet në shkresat e lëndës nuk mund të vërtetohen shkelja e pretenduar ankimore.

Nga arsyet e theksuara më lartë dhe duke u bazuar në nenin 118 par.1 të LZP-së, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës**

ZL.Anr.1084/2017 më datën 21.11.2017.

**Kryesues i Panelit**  
Hasan Shala



### ***Udhëzim Juridike:***

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*